

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		05.06.2020 20__	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-0607	18266		



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Raport i tubimit me publikun lidhur me gjashtë mujorin e parë të vitit 2020 dhe planifikimi për gjashtëmujorin e dytë

Komuna e Drenasit ka mbajtur takim me publikun në Sallën e Kulturës në Drenas duke iu përmbajtur distancës sipas masave të IKSHP-së për shkak të pandemisë Covid-19.

Ky tubim është thirrur dy javë para mbajtjes sic parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale me këtë rënd dite: Diskutim lidhur me aktivitetet e Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal 2020 dhe planifikimi i punëve për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti.

Takimin e ka hapur udhëheqësi i zyrës së informimit, Bekim Dobra, ndërsa për pikën ka folur kryetari i komunës, z. Ramiz Lladrovci.

Kryetari Lladrovci ka uruar që pandemia të kalojë me shpejtë dhe që si komunë të mos ketë shumë raste me virus dhe pasoja të tjera për qytetarët. Pas kësaj, ai ka vazhduar të njoftoj administratorët dhe të pranishmit e tjerë për projektet, punët dhe planet për gjashtëmujorin e dytë.

Administratorët e fshatrave kanë paraqitur kërkesat apo shqetësimet e banorëve që përfaqësojnë për disa projekte të cilat kanë marrë përgjigje nga i pari i ekzekutivit, z. Ramiz Lladrovci.

Administratori i fshatit Baicë, ka paraqitur disa shqetësime për lagjen Vrellaku, lidhur me asfaltim dhe kanalizim. Më konkretisht, administratori kërkoj që disa lagje të këtij fshati të lidhen në rrjet të kanalizimit, pastaj shtruarjen me zhavorr të lagjes Elshani, Lestrani, Topalli etj.

Lidhur me këto shqetësime, Kryetari Lladrovci kërkoi nga ai dhe gjithë administratorët bashkëpunim që nëse ndonjë projekt si ai kanalizimit apo asfaltimit nuk kryhen si duhen dhe

punëkryesi bënë demë, të njoftojnë komunën. NDërsa, për asfaltimin e lagjeve të përmendura, ai tha se shumica e tyre janë asfaltuara, ndërsa vetëm disa lagje kanë mbetur të asfaltohen sipas projektit.

Ndërsa, administratori i fshatit Krajkovë, Arben Haziri paraqiti dy shqetësime: Dëmtimi i trotuarit nga KEDS-i dhe rreziku nga qenet endacak.

Kryetari Lladrovci lidhur me këto dy kërkesa theksoi se KEDS duhet dhe ka për obligim që ku të bëjë dëme gjatë punimeve, ti sanoj më pas. NDërsa sa i përket qenve endacak, ka qenë temë që e kanë trajtuar dhe kanë bërë kërkesa të niveli qendror të cilët kanë marrë përsiper buxhetin sepse komuna nuk ka buxhet për trajtimin e tyre.

Administratori i fshatit Sankoc, Kadri Ajazi paraqiti shqetësimin për mungesë të ujit për pije dhe për 2500 metra rrjet të kanalizimit në disa lagje.

Kryetari Lladrovci e njoftoi se komuna po bënë projekte edhe me donator për ujësjellës. Faturat duhet të paguhen ndaj kompanisë në mënyrë që shërbimi të jetë si duhet dhe kompania ka për obligim që të bëjë riparimin e defekteve.


Bajram Qallapeku, administrator i fshatit Terstenik II, paraqiti kërkesën për mungesë të furnizimit me ujë të pijes, asfaltim të disa rrugëve e kanalizim.

Takimi përfundoi në ora 11:05 dhe pjesëmarrës ishin 46 persona.

Raportin e hartoi:

Bekim Dobra, Shef i Zyrës së Informimit



PROCESVERBAL

i Tubimit me Publikun

Tubimi me publikun është mbajtur në Sallën ne Kulturës në Drenas, për shkak të mbajtës së distancës mes pjesëmarrësve dhe të pranishëm ishin; kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, drejtor të drejtorive komunale, administratorë të vendbanimeve dhe qytetarë. Tubimi me publikun është thirrur dy javë para mbajtës së takimi, ashtu siç parashihet me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe është publikuar në ueb faqen zyrtare, në rrjetin social Fecebook, në tabelën e njoftimeve para objektit të Komunës dhe në portale.

Tubimi me publikun ka filluar me këtë rend dite: Diskutim lidhur me aktivitetet e Komunës për gjashtëmujorin e parë të vitit fiskal 2020 dhe planifikimi i punëve për gjashtëmujorin e dytë të këtij viti



Tubimin me publikun e ka hapur Udhëheqësi i Zyrës për Komunikim me Publikun, **Bekim Dobra** i cili edhe ka treguar arsyen e thirrjes së këtij takimi. Në bazë të Ligjit për vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin gjatë gjashtëmujorit të parë, të

vitit fiskal, pra ky qe ne sot po e mbajmë, dhe tjetri në fund vit. Për këtë tubim, Komuna ka bërë me kohë njoftimin dhe ka publikuar dy javë para në ueb faqe të Komunës, në rrjetin social të Komunës, njoftimi është vendosur edhe ne dy hyrjet e objektit të Komunës, është vendosur edhe në vendet me të frekuentuara si dhe në mediat online. Të nderuar të pranishëm, ndjej për obligim të ju njoftoj për rregullat e takimit! Tubimi me publikun ka karakterin informues për pjesëmarrësit, ku përfaqësuesit e Komunës ju njoftojnë për aktivitetet e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, për të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë pjesës së dytë të këtij viti, ndërsa ju të pranishëm, mund të bëni pyetje dhe të jepni propozime përfaqësuesve të zgjedhur komunal lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit dhe çështje të tjera që janë në interes të qytetarëve. Për të elaboruar aktivitetet e Komunës ne gjashtëmujorin e parë të këtij viti, për sukseset dhe sfidat, ftoj kryetarin e Komunës, z. Ramiz Lladrovci.

Kryetari Lladrovci –fillimisht uroj që gjendja nga virusi të kaloj sa më shpejt dhe të kalojmë ne si Komunë me sa më pak raste të prekura nga virusi. Siç jeni në dijeni, para dy dite janë lajmëruar 3 raste me covid-19, ndërsa mbrëmë i kemi 5 raste të reja e gjithsej kemi 8 raste aktive. Që nga muaji mars kur janë lajmëruar rastet e para, deri para tri dite kemi pasur vetëm një rast me covid-19, ndërsa rasti i dytë ka qenë i dyshimtë. Lehtësimi i masave e ka bërë të vetën dhe tani kemi 8 raste me virus, edhe tubimi i organizuar nga Vetëvendosje ka bërë që burimi i infeksionit nga virusi ka ardhur nga ky tubim. Para jush do të raportoj për punët të cilat janë kryer gjatë kësaj pjese të vitit fiskal, pra për gjashtëmujorin e parë të këtij viti. Ju e dini që në muajin Mars është aprovuar buxheti i Republikës së Kosovës dhe deri atëherë ne nuk kemi mundur të zhvillojmë asnjë procedurë e projekt dhe po në muajin mars ka filluar gjendja e jashtëzakonshme shëndetësore me covid-19 dhe Qeveria i ka bllokuar të gjitha fondet dhe nuk ka lejuar alokimin e tyre dhe ne nuk kemi mundur të zhvillojmë asnjë procedurë për të filluar në realizimin e projekteve. Me 12 mars e kemi formuar shtabin emergjent dhe pas një muaji e kemi formuar po ashtu edhe nënshtabin emergjent lokal, ku kanë marr pjesë në atë nënshtab të gjithë administratorët e fshatrave dhe kryesia e fshatrave çka edhe i falënderoj të gjithë që kanë bashkëpunuar maksimalisht për të menaxhuar sa më mirë gjendjen e krijuar nga pandemia globale covid-19 dhe për t'i ndihmuar qytetarët tanë. Gjatë vendimet e Qeverisë, pavarësisht se disa prej tyre kanë qenë anti kushtetuese, ne i kemi respektuar në përpikëri të gjitha ato. Gjatë gjithë asaj kohe, kemi pasur vetëm një rast pa shenja klinike që ka punuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe që nuk ka pasur me asnjë qytetarë tonin kontakt, pra nuk ka qenë për më shumë se një muaji në Drenas. Pastaj ne e kemi formuar edhe shtabin operativ lokal dhe kemi mbajtur 10 takime me dy shtabet. Me këtë rast, dua të falënderoj Policinë e Kosovës, stafin shëndetësor, kompanitë publike, pastrimin, ujësjellësin, KEDS-in, drejtor të drejtorive komunale, stafin e administratës komunale, administratorët e vendbanimeve dhe gjithë qytetarët. Kemi mbajtur 17 mbledhje të Bordit të Drejtorëve, 5 mbledhje të Kuvendit të Komunës dhe 2 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe një është thirrur për javën e kaluar. Komuna ka marr me kohë të gjitha veprimet e nevojshme për të menaxhuar situatën e pandemisë, kemi nda fillimisht 600 pako ushqimore-higjienike nga buxheti i subvencioneve të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe secila pako ka pasur 18

artikuj duke përfshirë edhe nga një thes me miell 25kg. Pastaj me Kuvend i kemi ndarë 229 mijë euro dhe janë shpenzuar vetëm 85 mijë euro për 2000 pako për familjet në nevojë dhe janë ndarë me të njëjtën sasi, pra me 18 artikuj dhe me një thes me miell për secilin përfitues. Për dhënien e kësaj kontratë, për të qenë sa më transparent kemi pasur në komision edhe anëtar të Kuvendit të Komunës nga pozitë e opozitë për të verifikuar secilën procedurë të blerjes së pakove. Komuna ka siguruar me buxhetin e saj 2600 pako, por kemi pasur edhe mbi 1500 pako nga donatorë të ndryshëm e që pako ka qenë standarde sikur ajo e Komunës, po ashtu nga donatorë kemi pasur edhe 3615 thasë me miell, apo 90375 kg me miell, apo në total 146150 kg. Sa i përket investimeve kapitale, ne nuk kemi mundur të zhvillojmë procedura për shkak që nuk kemi pasur alokim të buxhetit. Deri më tani kemi shpenzuar mjetet; sa i përket pagave dhe mëditjeve deri më tani kemi realizuar 99.91 për qind, apo nga shumën e ndarë 3,536,532.10 euro shpenzimi është prej 3,33,178.16 euro. Nga kategoria mallra e shërbime ka pasur një zhvillim prej shumës së ndarë 919,514.85 euro shuma e shpenzuar është prej 440,210.30 euro dhe në proces është shuma prej 110,756.74 euro, pra nga kjo kategori përqindja e shpenzimit deri më tani është 47.87 për qind. Nga kategoria e shërbimeve komunale, buxheti i ndarë prej 127,670.00 dhe buxheti i shpenzuar është prej 59,199, apo shprehur në përqindje është në 46.37%. Nga kategoria e subvencioneve dhe transferove, buxheti i alokuar është në shumën prej 238,747.37 dhe është shpenzuar shuma prej 116,000.00 apo 48.59%. Kategoria e investimeve kapitale, buxheti i ndarë në shumën prej 5,179,888.56 euro, ndërsa shpenzimi është në shumën prej 166,218.45 apo 3.21 për qind dhe në proces për shpenzim është shuma prej 2,617,821.90 euro. Shuma e vogël e shpenzimeve për investimeve kapitale është sepse alokimi i mjeteve ka ardhur tek në muajin maj dhe deri në atë kohë ne nuk kemi mundur të zhvillojmë asnjë procedurë, megjithatë vetëm për një muaj, në proces janë shumë projekte dhe me këtë tempo të punëve në terren, deri në fund të vitit do të realizohen të gjitha projektet e planifikuara për këtë vit. Unë sot jam para jush dhe ju mund të paraqitni kërkesat e juaja, sugjerimet dhe çështje të tjera. Juve si administrator ju jam shumë mirënjohës për bashkëpunimin e treguar gjatë kohës së pandemisë.

Rrahman Vrellaku – jam përfaqësues i lagjes Kiqina e Vrellaku të fshatit Baicë. Ne si lagje nuk kemi as kanalizim e as asfalt, kisha dashtë me e ditë pse nuk kemi ende, apo është në procedurë për këtë vit rregullimi i asfaltit, apo kanalizim, sepse mendoj që këto dy lagje kanë qenë të anashkaluar në projekte.

Kryetari Lladrovci – unë i kam marr kërkesat e juaja dhe ju kam kthyer përgjigje, sepse ato i keni paraqitur edhe tek unë. Kur thoni që lagja Vrellaku, nuk ka asfalt, nuk është ashtu, sepse rruga që kalon në fshatin tuaj, kalon përmes lagje Vrellaku, por pjesë të lagjes brenda që nuk keni asfalt, është e vërtetë, por ne për emergjencë, nga Drejtoria e Shërbimeve Publike kemi bërë shtrirje të zhavorit deri sa të asfaltohet rruga në lagje. Ju si përfaqësues i lagjes, e dini që ne mbajmë dëgjime publike për buxhetin e projektet dhe aty e dini sa mjete kemi mundësi të bëjmë në vendbanimin tuaj, prandaj ju duhet t'i tregoni ne këto takime prioritetet sepse lista e investimeve kapitale behët pikërisht nga dëgjimet buxhetore që dalin kërkesat e pjesëmarrësve të vendbanimeve. Sot në ora 2

keni takimin fillestar për prioritetet për investimet për vitin e ardhshëm, prandaj shfrytëzoni këtë takim dhe ato që do t'i mbajmë gjatë muajit gusht, në mënyrë që kërkesat e juaja të adresohen në listën e projekteve kapitale. Ne kemi pasur shumë probleme me rrjetin e ujësjellësit që janë kryer punimet vitet paraprake, sidomos në Kamenicë, projekti është kryer, kompania është paguar për punët që i ka krye, e që realisht nuk i ka vendos fare gypat në projekt, pra kemi raste kur 4 herë janë hapur procedura për të njëjtin projekt, për këtë arsye në shumë vendbanime ende nuk kam mundur t'i kryej punimet për t'i furnizuar me ujë të pijshëm shumë fshatra, sepse në shumë lagje e fshatra nuk ka fare gypa, ndonëse punimet janë kryer vitet paraprake, para se të marr unë qeverisjen.

Samedin Kiqina – administratorë në fshatin Baicë – është e vërtetë ajo që thotë parafolësi im nga lagja Vreallaku, se nuk kanë asfalt lagja e po ashtu as rrjet të kanalizimit. Rruga kryesore në lagjen Vrellaku vetëm kalon në atë pjesë, por nuk i prek ata, megjithatë unë të përgëzoj për punët që jeni duke i bërë. Fshati Baicë ka shumë kërkesa, i kemi 5 lagje pa u lidh në rrjetin e kanalizimit, dy lagje janë Kiqina, lagja Vrellaku, lagja Rrapini dhe lagja Elshani. Kanalizimi që është bërë vitin e kaluar në lagjen Kiqina, ka pasur shumë ankesa e pengesa në realizim të projektit dhe nuk është bërë siç duhet, në fillim kanë thënë se janë 1700 metra, ndërsa janë kryer vetëm 1000 metra, kur ka nisur punimet punëkryrësi, nuk ka treguar sa metra i ka në kontratë për me i krye, punimet nuk janë kryer mirë i kam edhe fotot, plus asaj edhe shaktat i kanë shti mbrapsht, kështu që kisha pas një kërkesë që të krijohet një komision kur të kryhen punimet sepse ato në terren nuk po kryhen mirë, nuk po ka kontrolla nga ana e komunës, prandaj kisha kërkuar që të behën inspektime. Në Baicë kemi lagje që nuk kalohet as me traktor, nuk kanë as zhavor e as kurgja, është lagja Elshani, lagja Lestrani, lagja Topalli që nuk ka asfalt, afërsisht 60 për qind e fshatit nuk ka asfalt. E kemi kërkesën që nga viti i kaluar, për një rrugë shoqërore, ku një person i ka bllokuar shumë banorë e kërkoj nga ana juaj të zgjidheni këtë problem, kërkesën e keni që nga viti i kaluar.

Kryetari Lladrovci – jo vetëm juve Samedin, por të gjithë administratorëve të fshatrave ju kam kërkuar që çdo tender, çdo projekt që zhvillohet në lokalitetet e juve, më ndihmoni dhe ti përcjellni punimet, kur të shihni që punëkryerësi nuk është duke punuar sipas kontratës, me na njoftu. Secilin kërkesën që e keni bërë, ju kam kthyer përgjigje, ju e dini, prandaj kërkoj nga ana juaj bashkëpunimin që projektet të kryhen ashtu edhe si nënshkruhen në kontratë për kryerjen e shërbimeve. Nuk besoj që 60 për qind është i pa asfaltuar në fshatin Baicë, besoj që keni më shumë, ju e dini që fill pas luftës vetëm rrugën Komoran-Drenas-Skenderaj ka qenë e asfaltuar, tani kemi të gjitha vendbanimet me asfalt, kanë mbetur vetëm disa lagje. Në secilin njoftim që ju ma keni bërë, unë kam marr masa, ju e dini që në Gllobar e kam detyruar me i largu gypat sepse nuk i ka punuar sipas kontratës, jo vetëm në këtë projekt, por në të gjitha projektet që me keni njoftuar, unë kam marr masat e nevojshme sipas ligjit, prandaj po kërkoj edhe në këtë takim nga ana juaj, që të bashkëpunoni në realizimin e projekteve sepse ju jeni përfaqësues të zgjedhur të vendbanimit tuaj dhe qytetarët i adresojnë tek ju kërkesa e ankesat e tyre, prandaj bashkëpunimi institucional duhet të jetë edhe më i mirë që projektet të realizohen ashtu siç parashihet në kontrata të nënshkruara. Ju jeni njoftuar për të gjitha projektet që kanë me u realizuar, sepse nga viti i kaluar kemi mbajtur

shumë takime me ju për të diskutuar projektet e këtij viti dhe secila kontratë e secila procedurë publikohet në ueb faqe të komunës dhe ju duhet t'i përcjellni secilën kontratë për me e ditë se si do të zhvillohet projekti në vendbanimin tuaj. Edhe zyrtarët përgjegjës të komunal, janë të obliguar të dalin çdo herë në realizimin e projekteve për t'i mbikëqyrur ato, janë të obliguar të dalin edhe vikendeve. Ju e dini që fshatin Gllobar ka qenë grant, dhe kam mrri që të gjitha lagjet të kryhen në atë projekt, pra janë asfaltuar të gjitha lagjet në fshatin Gllobar me një projekt, ka qenë vetëm deri të pishat, ashtu siç e kam kry rrugicat në Fushticë, në Sankoc e që kanë me u kry edhe rruga Vasilevë-Poklek. Për të gjitha projektet që kam marr njoftimin nga ana juaj që nuk janë duke u punuar siç duhet ne kemi marr masat. Shumë zyrtar sot që nuk i kanë përcjellë punimet, janë nën hetime e kanë me pas edhe të tjerë që nuk i kanë përcjellë punimet e që kanë qenë të obliguar. Ju e dini që më herët një shërbim në Komune me e kry, u dashtë tri ditë e më shumë, sot i njëjti shërbim kryhet për 2 minuta, pra i kam kthyer punëtorët në punët e tyre, nuk do të këtë asnjë punë ma që kryhet shkel e shko, por me përgjegjësi të plot.

Arben Haziri – Administratorë nga fshati Krajkovë – ne si fshat kemi dy shqetësime, vitin e kaluar ka punuar KEDS-i në një projekt dhe e ka dëmtuar trotuarin dhe është mirë që të kthehet në gjendjen siç ka qenë dhe shqetësimi i dytë është se ne po rrezikohemi nga qentë endacak dhe është mirë të behët një zgjidhje për ta se po rrezikohen sidomos fëmijët.

Kryetari Lladrovci – sa i përket dëmtimeve të trotuarit, kompania është e obliguar që kur ti bëjë dëmtimet, duhet t'i sanoj ato dhe t'i kthej në gjendje të mëparshme, ju jeni në dijeni që i kemi shkruar KEDS-it për këtë çështje, dhe besoj që do të merren masat për sanimin e tyre. Sa i përket qenve endacak, ka tri vjet afërsisht që niveli qendror ka marr përsipër buxhetin për me i trajtuar qentë endacak, ne i kemi bërë kërkesat nivelit qendror për të marr masat, por edhe ju duhet të bëni kërkesa të vazhdueshme, sepse komuna nuk ka buxhet për trajtimin e tyre. Ne po mundohemi që në secilën lagje që po bëjnë në mënyrë vullnetare ndriçimin, ne do t'i marrim përgjegjësitë për pagesat e faturave të shpenzimeve.

Kadri Ajazi – Administratorë e fshatit Sankoc - kemi shqetësim të madh në fshat për mungesë të ujit për pije, e po ashtu kemi edhe 2500 metra rrjet të kanalizimit kemi nevojë në disa lagje. Është një ujësjellës rural me pompa në fund të fshatit, është investuar pas luftës përmes OXFAM-it dhe bashkëfinancimin e banorëve, por ka mbetur i pa shfrytëzuar ajo pjesë, tash e ka marr ujësjellësi nën menaxhim, por më shumë se 70 për qind të fshatit nuk ka ujë. Falënderoj Drejtorinë e Shërbimeve Publike që ka bërë përpjeke, por ne ende nuk kemi ujë të pijes.

Kryetari Lladrovci – komuna bënë projekte edhe me donatorë dhe me buxhet komunal për ujësjellës, por pastaj kalojnë në menaxhim të kompanisë së ujësjellësit. Prandaj faturat duhet paguar ndaj kompanisë, që shërbimi të jetë si duhet, nëse ka defekte, kompania ka për obligim të bëjë riparimin e defekteve dhe sanimin e tyre. Është mirë që ju si administratorë, të bëni kërkesë në kompani për të rregulluar secilin defekt.

Bajram Qallapeku – Administratorë në fshatin Tërstenik II – ne ju falënderojmë për punët e kryera deri më tani, por jemi ende mbrapa me shumë projekte. Kemi mungesë për ujësjellës në shumë lagje, disa rrugë po ashtu kanë mbetur pa u asfaltuar dhe kam bërë disa herë kërkesa që të kryhen ato e po ashtu kemi edhe disa lagje pa rrjet të kanalizimit.

Kryetari Lladrovci – në takimin që e kemi thirr sot në ora 14:00 që ka të bëjë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2021-2023, mund t'i adresoni kërkesat për vitet e ardhshme, në këtë takim fokusoni në projektet e këtij viti.

Takimi ka përfunduar në ora 11:05. Pjesëmarrës ishin 46 vetë. Më gjerësisht, takimi është në audio incizim.




Procesmbajtësi:


Bekim Dobra



Kryetari i Komunës


Ramiz Lladrovci